



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva

Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

FTESË PUBLIKE

Për aplikim në projektin:

Furnizimi dhe montimi i serrave

- 134 përfitues me serra 50 m²
- 10 përfitues me serra 500 m²
- 5 përfitues me serra 1000 m²

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

1. Kopja e letërnjoftimit të Republikës së Kosovës;
2. Çertifikata e bashkësisë familjare;
3. Vërtetimi i tatimit në pronë;
4. Çertifikata mbi pronësinë e tokës dhe skica e planit;
5. Çertifikata e regjistrimit të fermerit NIF-i;
6. Raport i pagesave direkte/subvencioneve 2025 (për aplikuesit e serrave 500 m² dhe 1000 m²).

Kushtet e përgjithshme për aplikim:

- Të jetë i/e regjistruar si fermer para datës së publikimit të thirrjes për aplikim;
- Fermeri/ja të ketë përshtatshmëri të vendit për realizimin e projektit;
- Të ketë mundësi të mjaftueshme për ujitjen e serrës.

Kushtet e veçanta për aplikim:

- Të jetë kultivues i perimeve (për aplikuesit e serrave 50 m²);
- Të ketë së paku 1ha tokë bujqësore, përkatësisht 20 ari tokë bujqësore të kultivuar me perime (për aplikuesit e serrave 500 m²);
- Të ketë së paku 1ha tokë bujqësore, përkatësisht 50 ari tokë bujqësore të kultivuar me perime (për aplikuesit e serrave 1000 m²).

Përparësitë për aplikim:

Poena

1.Aplikuesit të cilët nuk kanë përfituar ndonjë projekt nga Komuna apo donatorët në bashkëpunim me Komunën në 3 vitet e fundit;	10
2.Aplikuesit me përgatitje profesionale shkollore (fakulteti i bujqësisë, student);	10
3.Përparësi të aplikimit kanë aplikueset gra;	10
4.Aplikuesit me numër të anëtarëve (1-5 anëtarë,5 pikë) dhe (mbi 5 anëtarë, pikë);	10
5.Vizita në terren .	0-50

Sqarim:

Projekti do të realizohet në bashkëpunim me përfituesit.

- ❖ Fermerët përfitues do të marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit.
- ❖ Komuna në cilësinë e subvencionuesit do të marrë pjesë me 70% të vlerës së projektit.

Vërejtje! Fermerët kanë të drejtë të aplikojnë vetëm për njërën nga tri dimensionet e ofruara të serrave. Aplikimet për më shumë se një nga dimensionet nuk do të merren në konsideratë.

Aplikacionet (kërkesat) dorëzohen në Zyrën e Shërbimit të Qytetarëve

Afati i aplikimit është deri me datën 27.11.2025, ora 16:00.

Nr:12-320/01-0071960/25

Podujevë

7 Nëntor 2025



Drejtori i BPZHR:
Lirie Hoti Rama